

Gjëra të Vogla, Ndryshim i Madh (pjesa 1 nga 4)

Gëzohem që ndodheni këtu sot.

Sot do të fillojmë një seri të re: **Gjëra të Vogla, Ndryshim i Madh.**

Herë pas here ndodh që e krahason veten me dikë dhe thua, “Sa i zoti është filani apo filanja në filan gjë. Dhe unë dua të jem ashtu, por s’di nga t’ia filloj, si të jem ashtu.

Çfarë gjërash të mëdha duhet të bëj që të kem rezultatet që dua, ndryshimin që dua?”

Unë mendoja që ndryshimi i madh ndodh për shkak të gjërave të mëdha që duhet të bësh. Nëse ke qenë duke menduar, “Unë dua të ndryshoj, por gjërat e mëdha s’di a i bëj dot,” lajmi i mirë është ky:

Shpesh ndodh kështu: Gjërat e vogla, ato që s’i sheh askush, ato sjellin gjërat e mëdha që i dëshiron çdo njeri.

(Shembull:

Ja ta ilustruj: para disa vitesh po bisedoja me një lider të krishterë dhe e admiroja për sa shumë e donte Zotin dhe sa i përkushtuar ishte. Lutej shumë dhe e njihte Biblën shumë mirë. Kur e pyesje për diçka, përgjigja e tij kishte lidhje me ndonjë varg ose pasazh nga Bibla. Dhe kishe atë ndjesinë se ky po ecën fuqishëm me Zotin çdo ditë. “Po cili është sekret i yt, more njeri?” e pyeta, me idenë se do të jetë ndonjë gjë e madhe që duhet të bëj për të qenë si ky. Dhe përgjigja e tij ishte: “Sinqerisht, ndryshimi ka filluar të ndodhë para 17 vitesh, kur fillova të lexoj Biblën çdo ditë nga 15 minuta dhe që nga ajo kohë e lexoj Biblën e plotë çdo vit.” Kjo është e vërtetë: nëse lexon 3 kapituj të Biblës çdo ditë, do ta mbarosh atë brenda një viti. Ai tha se kjo gjë, 15-20 minuta çdo ditë me Perëndinë, ka sjellë ndryshim në jetën e tij.)

Dita ka 96 çerek ore. Vetëm nëse bën këtë gjë të vogël çdo ditë gjatë gjithë vitit, vetëm 1 çerek ore në ditë duke lexuar Biblën, do ta mbarosh atë deri në fund të vitit.

Kjo gjë e vogël ka sjellë dhe po sjell çdo ditë një ndryshim të madh në jetën time dhe në miqësinë time me Perëndinë, si dhe në marrëdhëniet me shumë persona të tjerë që bëjnë të njëjtën gjë. Është një gjë e vogël, por sjell një ndryshim të madh.

E njëjta gjë ndodh edhe me shëndetin fizik. Nëse kujdesesh çdo ditë, do të jesh më i shëndetshëm. Po lexoja diku që thoshte: "20 minuta vrap dhe 20 minuta pesha – kaq, 40 minuta dhe 4 ditë në javë." Dietë me pak karbohidrate dhe

shumë proteina. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë janë gjëra të vogla që sjellin ndryshim të madh.

Një shembull tjetër i gjërave të vogla që sjellin ndryshim të madh është martesë. U pyet një këshillues martesash, që ishte shumë i zoti, se cila është gjëja më e rëndësishme për një çift të martuar. Ai, pa hezituat, tha menjëherë: "Kur çifti lutet çdo ditë së bashku." Po si luten? A duhet të luten një orë çdo ditë? Ai tha: "Jo, jo, një lutje e thjeshtë para se të dalin nga shtëpia, para se të shkojnë në punë, mund të jetë edhe në darkë. Një lutje që zgjat 30 sekonda ose 2-3 minuta. Të zgjasë sa të jetë e rehatshme për secilin."

Por si ndodh ndryshimi i madh? Ai tha: "Nëse dy njerëz luten së bashku, ka shumë mundësi që edhe do të flasin më shumë bashkë. Kur luten së bashku, do të lidhen më shumë në shpirt me njëri-tjetrin, sepse nuk mund të lutesh me dikë që të ka inat ose që s'je pajtuar ende. Për çiftet e martuara, nëse vendosin të luten çdo ditë së bashku, kjo do të sjellë që çifti të mos mbajnë inat ndaj njëri-tjetrit asnjë ditë dhe të mos ndahen me inat."

Ideja e mesazhit sot është kjo: Besoj me gjithë zemër që ti mund të kesh një vit të shkëlqyer. Dhe më shumë mundësi, a e di si do të jetë i shkëlqyer? Jo duke pritur ndonjë gjë të madhe nga qielli, jo duke pritur gjëra magjike, por duke bërë këto gjëra të vogla, ato që s'i sheh askush, sepse këto sjellin gjërat e mëdha që çdo njeri i dëshiron.

Ajo që dua të bëjmë sonte është të hedhim themelet e kësaj ideje. Do të lexojmë nga Zakaria kapitulli 4. Ja një përmbledhje e shpejtë e kontekstit të këtij libri: Në kohën kur u shkrua ky libër, tempulli ku izraelitët adhuronin Perëndinë ishte shkatërruar dhe i gjithë populli i Perëndisë kishte qenë në mërgim në Babiloni. Ishin ditët më të errëta për Izraelin. Njerëzit nuk kishin një vend ku të adhuronin Perëndinë dhe nuk ishin në shtëpitë e tyre. Ata ishin shumë të trishtuar. Në vitin 535 para Krishtit, Zorobabeli drejtoi një pjesë të izraelitëve nga mërgimi për në tokën e tyre, dhe në atë kohë filloi një fije shprese për popullin sepse po ktheheshin në tokën e tyre, në vendin e tyre, po ktheheshin në shtëpi.

Pastaj Perëndia i foli Zorobabelit:

Zakaria 4:6 *'Atëherë ai (Perëndia), duke u përgjigjur, më tha: "Kjo është fjala e Zotit drejtuar Zorobabelit: Jo për fuqinë dhe as për forcën, por për Frymën time", thotë Zoti i ushtrive.'*

Me fjalë të tjera, nuk do të arrish të realizosh këtë ndryshim vetëm me fuqinë dhe forcën tënde. Nuk do të marrësh lavdinë për këtë punë; kjo është për Frymën e Perëndisë, thotë Zoti.

Ideja është se ti mund të provosh të ndryshosh me fuqinë dhe vullnetin tënd, por nëse lidhesh me energjinë e Frymës së Perëndisë, një fuqi shumë më e madhe, ndryshimi do të jetë shumë më i madh. Ndonëse ti mund të përpiqesh me forcën tënde, ndryshimi i vërtetë ndodh kur ndihmon Fryma e Perëndisë. Me fuqinë e Perëndisë, Ai mund të transformojë dhe të forcojë ty në mënyra që nuk mund t'i arrish vetëm.

Ti mund të bësh më të mirën që di, por nëse nuk ke një burim të jashtëm, energjinë e Frymës së Shenjtë, nuk do të arrish ndryshimin që dëshiron.

Ndoshta disa prej jush kanë vite apo muaj që po përpiqen të ndryshojnë diçka apo të përmirësojnë ndonjë aspekt të jetës së tyre dhe nuk po arrijnë të kenë rezultate. Ky është viti ku ti vendos të veprosh, jo me fuqinë dhe forcën tënde, por me Frymën e Perëndisë.

Perëndia u tha atyre: “Unë do t’ju jap fuqinë time që të jeni në gjendje të ri-ndërtoni tempullin.”

Zakaria 4:7 *“Kush je ti, o mali i madh? Përpara Zorobabelit ti do të bëhesh fushë... ”.*

Kur Perëndia thërret dikë për të bërë diçka, siç ishte rasti i Zorobabelit, nuk ka forcë në botë që mund të ndalë vullnetin e Perëndisë të realizohet përmes atij personi.

Kur Zorobabeli të vendosë gurin e fundit në ndërtimin e tempullit, të gjithë do të thonë: "Zoti e ka bekuar."

Është fantastike të shikosh se si, përpara se të fillojë ndërtimi, Perëndia sheh fundin e ndërtuar.

Kjo do të thotë se, përpara se ti të provosh të bësh diçka që Perëndia të ka vënë në zemër, Ai e di rezultatin që do të dalë nëse ti mbështetesh në fuqinë e Frymës së Tij.

Zakaria 4:8-9 *'Fjala e Zotit m'u drejtua përsëri, duke thënë: "Duart e Zorobabelit kanë hedhur themelet e këtij tempulli dhe duart e tij do ta përfundojnë...'*

Prit një çikë, për ndërtimin e tempullit flitet edhe në librin e Ezdras, dhe nuk shkoi gjithçka siç ishte planifikuar, madje u bë shumë ngadalë. Kishte momente kur njerëzit erdhën për ta parë dhe filluan të qanin.

Arsyeja pse ata qanin nuk është e qartë. Disa thonë se qanin nga gëzimi që tempulli po ndërtohej. Por shumica mbrojnë idenë se qanin sepse ndiheshin të turpëruar nga ky tempull që po ndërtohej, pasi nuk ngjante fare me tempullin

madhështor që kishte ndërtuar Solomoni. Dukej si një kolibe në krahasim me tempullin origjinal.

Shpesh kështu ndihemi edhe ne. Ti mundohesh të mbash dietë dhe ndihesh i uritur për bukë, mundohesh të lesh cigaren dhe të ndizet hunda për një cigare, mundohesh të kursesh, por sapo prishe të gjitha paratë që kishe në portofol.

Pastaj i thua vetes: "Jo, more, nuk e bëj dot këtë gjë, nuk është punë për mua." Gjithë ky tension, të thotë: "Kam tre ditë që mundohem dhe vetëm gjysmë kg kam humbur, dhe u peshova para drekës."

Ideja e hapave të fillimit është e sikletshme, ka shumë tension dhe ndihesh i turpëruar dhe i shqetësuar që nuk ecën fare, sepse ndryshimi gati nuk dallohet.

Zakaria 4:10 *'Kush ka mundur të përçmojë ditën e gjërave të vogla? Por ata të shtatë gëzohen kur shohin plumbçen në duart e Zorobabelit. Ata të shtatë janë sytë e Zotit që e përshkojnë gjithë dheun'.'* (mos i përçmoni gjërat e vogla sepse Zoti gëzohet kur fillon puna.)

Duhet të vendosësh gurin e parë, pastaj të vijë guri i dytë, pastaj të mbyllet radha e gureve që të fillojë të ndërtohet muri.

Çdo gjë fillon me diçka, dhe Perëndia gëzohet kur ti je besnik me gjërat e vogla.

Një nga sfidat e mia është: Ndjek parimin "Më thuaj cilët libra dhe nga cilët persona po mëson, që të them se kush do të bëhesh."

Kur shikoj në Bibël, p.sh. Davidin, njeriun sipas zemrës së Zotit, që e vrau Goliathin me një gur dhe një hark, edhe unë dua të shemb në tokë gjigantin që më tmerron mua dhe me një gur të vetëm. Por ajo që harroj herë pas here është se Davidi ishte një njeri besnik në gjërat e vogla gjatë gjithë jetës së tij. Kur ishte djalosh, ai ishte bari dhe praktikonte gjuajtjet me hark. Thuhet se kur një kafshë e egër vinte për t'i rrëmbyer delet, ai merrte harkun, e ndiqte dhe e vriste. Çfarë po bënte? Ai ishte besnik me gjërat e vogla, praktikonte gjërat e vogla dhe Perëndia e përgatiste për jetën e tij, për gjëra të mëdha.

Ose njerëz të tjerë në Bibël, p.sh. Ruthi dhe Boazi. Kur vajzat lexojnë këtë histori, thonë: "Sa do të doja të isha martuar me një burrë si Boazi, sepse duket si një burrë i jashtëzakonshëm." Mirë, por nga ana tjetër, mos harro besnikërinë e Ruthit ndaj Naomit. Ajo u tregua besnike, kur ishte e lirë për të zgjedhur të bënte atë që dëshironte. Ajo ishte besnike në arat e grurit, duke punuar vit pas viti. Besnikëria e saj hapi dyer të bekimeve të Perëndisë. Ishin gjërat e vogla që ajo bënte, gjëra që nuk i shikonte askush, që i sollën një martesë që do e dëshironte çdo njeri.

Ose Danieli, për të cilin thuhet: “Çfarë njeriu me besim të madh që ishte Danieli.” Ai qëndroi në gropën e luanëve dhe nuk u tremb, nuk e mohoi Perëndinë. Ne dëshirojmë të luftojmë si ai, por harrojmë që Danieli lutej 3 herë në ditë. Vit pas viti, ai lutej dhe binte në gjunjë para Perëndisë. Si do të ishte besimi yt nëse do luteshe 3 herë në ditë dhe do kaloje kohë me Zotin 3 herë në ditë? Gjërat e vogla, ato që nuk i sheh askush, sjellin gjërat e mëdha që çdo njeri i dëshiron.

Prandaj, ja se çfarë do të bëjmë në 3 të dielat në vazhdim. Do të fokusohemi në tre zona të rëndësishme të jetës: mendimet, fjalët dhe zakonet e jetës së përditshme. Do të shqyrtojmë se cilat ndryshime të vogla mund të bëjmë.

Pse janë të rëndësishme mendimet? Sepse pasi e ke menduar diçka, e thua me fjalë, dhe pas fjalëve vijnë veprimet. Veprimet, kur përsëriten, bëhen zakone në jetën e përditshme dhe zakonet formojnë karakterin tënd.

Javën tjetër do të shohim si të bëjmë disa ndryshime të vogla në mënyrën e të menduarit, sepse, siç mendon një person në mendjen e tij, ai lloj personi është.

Më pas, do të shqyrtojmë si të bëjmë ndryshime të vogla në fjalët që themi. Në fund, do të fokusohemi në ndryshime të vogla lidhur me veprimet që ndërmarrim.

E di pse? Sepse gjërat e vogla, ato që nuk i sheh askush, sjellin gjërat e mëdha që i dëshiron çdo njeri. Nuk ke idenë se sa fuqi ka një jetë e fokusuar. Kur fokusohesh në diçka, nuk ke idenë sa i zoti bëhesh në atë gjë.

Ka shumë fuqi në fokusimin e jetës. Është si drita: kur e fokuson me lupë, bën vrima në letër ose djeg barin e tharë; por kur e fokuson më shumë, prodhon rrezet lazer që prishin dhe hekurin.

Çfarë tha Pali, që ishte apostulli më i madh i të gjitha kohërave? Kur lexon letrat e tij, duket se ai ka pasur një të shkuar shumë të vështirë. Ai përjetoi shumë persekutime: e rrahën, iu mbyt anija, e rrahën deri sa e lanë për të vdekur një herë, e pickoi një gjarpër, e goditën me gurë disa herë. Një jetë plot sfida dhe përpjekje të shumta.

Dhe ai tha që do të bënte një gjë:

Filipianëve 3:13b '*...duke harruar ato që kam lënë pas dhe duke u prirur drejt atyre që kam përpara,*'

“Unë nuk do të le të shkuarën të më prishë të ardhmen. Perëndia ka diçka më shumë për mua. Ja se çfarë do bëj: do ta harroj atë që ka kaluar dhe do të lëviz përpara me Perëndinë.” Ai bëri gjëra të mëdha sepse u fokusua te kjo gjë.

Një shembull tjetër është kur Jezusi shkoi në shtëpinë e Martës dhe Marisë, siç përshkruhet në Lukën 10. Maria po kënaqej në praninë e Jezusit dhe duke e dëgjuar Atë, ndërsa Marta tha: "Po bëj vetë të gjitha punët e shtëpisë; kam përgatitur ushqimin, po nuk gjej pjatat; kam bërë sallatën dhe desha të bëj edhe ëmbëlsirë, por nuk po arrij dot se Maria nuk po më ndihmon." Apo çfarëdo të ketë qenë situata ekzakte. Thjesht po përdor imagjinatën.

Jezusi pastaj e pa drejt e në sy dhe i tha:

Luka 10:41-42 *'Por Jezusi, duke u përgjigjur, i tha: "Martë, Martë, ti po shqetësohesh dhe kujdesesh për shumë gjëra; por vetëm një gjë është e nevojshme, dhe Maria zgjodhi pjesën më të mirë, që asaj nuk do t'i hiqet".'*

Marta, ty po të ikën nga duart pjesa më e rëndësishme.

Një herë tjetër, Jezusi takoi një djalosh të ri, një biznesmen të suksesshëm dhe shumë të pasur, i cili dëshironte të ndiqte Jezusin. Ai i tha: "Jezus, unë dua të jem pjesë e skuadrës tënde." Problemi i tij ishte se ishte shumë i fokusuar te pasuria; ai ishte aq i lidhur me paratë sa që ato kishin marrë një rëndësi të madhe në jetën e tij, duke e bërë të humbiste mundësinë për të qenë pjesë e skuadrës së Jezusit. Djaloshi iku i trishtuar sepse nuk mund të hiqte dorë nga pasuria e tij.

Ja se çfarë do doja që të bëje këtë vit për të qenë sa më i fokusuar. Mos u hallakat duke vendosur 10 synime ose 15 gjëra për të bërë. Dëshiroj të të nxis të mendosh vetëm për një fjalë, një fjalë të veçantë që do të të mbajë të fokusuar gjithë vitin dhe një varg që e shoqëron atë fjalë. Që të duket qartë se do ta arrish atë, jo me fuqinë apo forcën tënde, por me Frymën e Perëndisë. Dhe do të habitesh edhe ti vetë sa ndryshe do të jetë ky vit për ty.

Forcohuni.

1 Pjetrit 5:10 *'Dhe Perëndia i çdo hiri, që ju thirri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin Jezus, mbasi të keni vuajtur për pak kohë, do t'ju bëjë të përsosur ai vetë, do t'ju bëjë të patundur, do t'ju forcojë dhe do t'ju vërë themel.'*

Isaia 54:2 *'Zgjero vendin e çadrës sate dhe fletët e banesave të tua le të shtrihen pa kursim; zgjati litarët e tu dhe përforco kunjat e tu,'*

Flet për rritjen dhe rëndësinë e thellimit dhe forcimit.

Unë besoj se Perëndia do ta rrisë shumë më tepër influencën e kishës sonë këtë vit. Çfarë duhet të bëjmë? Duhet të sigurohemi që kunjat e tendës sonë të jenë të forcuara dhe të themeluar, ndërsa kjo tendë po zgjerohet.

Ky do të jetë synimi i këtij viti: Forcimi. Gjerat që do të ndodhin nga e hëna në të shtunë, jo vetëm ato që ndodhin të dielën, do të kontribuojnë në forcimin e kishës, forcimin tonë personal, forcimin e familjeve tona, punëve dhe shkollave tona. Si ta bësh këtë në çdo zonë të jetës tënde? Si të jesh më i fortë në fund të vitit, duke bërë gjërat e vogla?

Le të lutemi.